



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-292605/19 dt. 29.11.2019, në emër të aplikuesve Fahri, Remzi dhe Fehmi Grajqevci, Afrim, Mehmet dhe Lulzim Cakolli, Hamdi Shaqiri dhe Shefqet Publica, me investitor “Valony Company” shpk, me seli në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “C6” të Planit Rregullues “Mati I”, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 780-5, 780-6, 780-7, 785-4, 785-5, 785-14, 786-2, 786-3 dhe 786-4 ZK Matiçan, të cilat ndodhen në kuadër të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 19.12. deri më 02.01.2020, në e-mail adresën: urbanizmi@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Kompleks me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, me etazhitet B+S+P+9
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	1.50 m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	1.50 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	Më kufi të parcelës ~ 7.35÷27.70 m` ~ 12.05÷24.50 m` ~ 3.57÷29.10 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40% ose 34.4%/1231.90 m ²
g. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=20 % ose 30.01 % /1072.80 m ²
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=3.0 ose 12793.50 m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 % ose 66.99%/2395.00 m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	106 vendparkime në garazhe 32 vendparkime të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

